REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 37/23
Datë/Datum. 02.02.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 37/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja Higjienikë e Objekteve të Qendrës së Studenteve" me numër të prokurimit: 1020890500-22-12575-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Qendra e Studenteve, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 02.02.2023 , mori këtë:

VENDIM

1. **Hedhet si jo e plotë** ankesa OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë e datës 13.01.2023 (protokoll 37/2023) , për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja Higjienikë e Objekteve të Qendrës së Studenteve" me numër të prokurimit: 1020890500-22-12575-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Qendra e Studenteve.

2. I lejohet autoritetit kontraktues – Qendra e Studenteve , që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja Higjienikë e Objekteve të Qendrës së Studenteve" me numër të prokurimit: 1020890500-22-12575-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Qendra e Studenteve, përkitazi me ketë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër .

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit, respektivisht zyra për pranimin e ankesave në sistemin elektronik të ankesave me datë 13.01.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja Higjienikë e Objekteve të Qendrës së Studenteve" me numër të prokurimit: 1020890500-22-12575-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Qendra e Studenteve.

Zyrtarja për të Hyra në OSHP e ka konfirmuar se në llogari të OSHP-së, nuk ka mjete te deponuara nga OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë, për ankesën me numër të protokollit 37/2023, të datës: 13.01.2023 sipas formularit të Pagesës për Depozite për Sigurim të Ankesës të ofruar nga OE në fjalë.

Pra sipas verifikimit te kësaj ankese nga zyra e pranimit te ankesave dhe zyrtarja për të hyra vërtetohet, se ankuesi për ankesën në fjalë nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ne pajtim me paragrafin 4 te nenit 111 të LPP-së, me datën 13.01.2022, e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart i ka bashkangjitur formularin standard për sigurim të depozitës por të njëjtës ankesë nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës, ku OSHP ka verifikuar llogarinë e saj nga Zyrtarja për te hyra dhe ka rezultuar se për ankesën në fjalë nuk janë deponuar fare mjetet në llogari të OSHP-së, andaj ne pajtim me dispozitën e cekur si me lart ju lutem qe ta plotësoni ankesën tuaj brenda afatit ligjor te paraparë me paragrafin 4 te nenit 111 te LPP-së.

Edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së për OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë, i njëjti OE brenda afatit te paraparë ligjor nuk e ka kompletuar ankesën e tij me tarifën e depozitës së sigurimit te ankesës në fjalë .

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "DEINFEKTIMI AD" SHPK Prishtinë, e datës: 13 .01.2023 (protokoll 37/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja Higjienikë e Objekteve të Qendrës së Studenteve" me numër të prokurimit: 1020890500-22-12575-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Qendra e Studenteve, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së, lidhur me nenin 118 të LPP-së, edhe për kundër faktit se i njëjti ishte njoftuar nga OSHP për plotësim te ankesës se tij ne pajtim me paragrafin 4 te nenit 111 te LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit te kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur te njëjtën ankesë si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet me dispozitat e LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Qendra e Studenteve
1x1 OE "DEINFEKTIMI AD SHPK Prishtinë
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së